



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E AUDITIMIT

URDHËR

Nr. 69, datë 29.09.2010

Për

Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Në mbështetje të nenit nr.8, të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Auditimit:

URDHËROJ;

1. Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm, sipas përmbajtjes (tekstit) bashkëlidhur këtij urdhëri.
2. Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (NjQH/AB) në Ministrinë e Financave, ngarkohen me ndjekjen e procedurave për botimin e këtij urdhëri dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Fletoren Zyrtare.
3. Manuali i Auditimit të Brendshëm, hyn në fuqi më datë 01 Janar 2011.
Ky Manual është dokument reference për të gjithë drejtuesit e njësive (institucioneve) të qeverisjes qendrore dhe lokale, që janë subjekt i zbatimit të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar dhe shërben për të ndihmuar këto njësi (institucione) që të hartojnë manualet e veçanta (specifike) të auditimit të brendshëm me qëllim që të sigurohet realizimi i këtij shërbimi në përputhje me ligjin e auditimit dhe standardet e auditimit.
4. Drejtuesit e njësive (institucioneve) të qeverisjes qendrore dhe lokale, në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e auditimit të brendshëm, në bashkëpunim me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, deri më datë 30.06.2011 të miratojnë tek titullari përkatës, Manualin e tyre të veçant (specifik) të Auditimit të Brendshëm dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm.
5. Të gjitha njësitë (institucionet) e qeverisjes qendrore dhe lokale, janë të detyruara që të realizojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, në bazë të nenit 17, të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

6. Njësitë (institucionet) e qeverisjes qendrore dhe lokale që nuk kanë ngritur struktura të auditimit të brendshëm, dhe që vendosin që në strukturën dhe përbërjen e tyre organike të funksionojnë edhe strukturat e auditimit, janë të detyruara të bashkëpunojnë me Njësinë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, dhe brenda 6-të, muajve nga ngritja e strukturave të auditimit të miratojnë tek titullari përkatës, Manualin e tyre të veçant (specifik) të Auditimit të Brendshëm dhe Kartën e Auditimit të Brendshëm.
7. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, është përgjegjëse për organizimin e veprimtarive (Takime, Workshope apo Seminare trajnimi) me titullarët e njësive (institucioneve) të qeverisjes qendrore dhe lokale për t'i njohur ata mbi rolin dhe rendësinë e shërbimit të auditimit të brendshëm, si dhe me drejtuesit dhe punonjësit e auditimit të brendshëm për trajnimin e tyre, me qëllim implementimin e kërkesave të ligjit dhe të këtij Manuali dhe akteve të tjera që bëjnë të mundur realizimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik.
8. Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave, ngarkohet të hartoj Udhëzimin e Ministrit të Financave “Për zbatimin e kërkesave të Manualit të Auditimit të brendshëm”, si dhe akte të tjera të nevojshme për implementimin e kërkesave të parashikuara në ligj apo në këtë Manual.
9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë. Për ndjekjen dhe zbatimin e tij ngarkohen: Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, Drejtuesit e njësive (institucioneve) të qeverisjes qendrore dhe lokale dhe të gjithë Drejtuesit e njësive të auditimit të brendshëm pranë njësive (institucioneve) të qeverisjes qendrore dhe lokale, që janë subjekt i zbatimit të ligjit Nr.9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” të ndryshuar.

Ridvan BODE

MINISTER